



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
Komisioni për Ekonominë dhe Financat

PROCESVERBAL

Tiranë më, 26.02.2019, ora 10.00

Drejton mbledhjen:

Arben Ahmetaj– Kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit
2. Shqyrtimi i projektligjit për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.125/2013, “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, të ndryshuar””.

Marrin pjesë:

Arben Ahmetaj, Anastas Angjeli, Antoneta Dhima, Ervin Bushati, Evis Kushi, Roland Xhelilaj, Blerina Gjylameti, Senida Mesi, Vullnet Sinaj, Ismet Beqiraj, Pjerin Ndreu,

Mungojnë:

Illir Xhakolli, Xhevit Bushaj, Reme Lala, Jorida Tabaku, Edmond Spaho, Agron Shehaj, Fatbardha Kadiu, Nadire Meçorapaj, Dashamir Shehi, Edmond Haxhinasto, Përparim Spahiu.

Të ftuar:

Albana Shkurta – Zëvendësministre

Rovena Beqiraj – Drejtore

Alda Klosi – Drejtore

HAPET MBLEDHJA

Arben Ahmetaj – Mirëmëngjesi!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit për Ekonominë dhe Financat. Në rend dite kemi miratimin e procesverbalit të datës 18, si dhe shqyrtimin e projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.125/2013, “Për koncesionet dhe partneritetin publik-privat”, të ndryshuar””.

Jeni dakord me procesverbalin e datës 18?

Miratohet.

Faleminderit!

Vazhdojmë me pikën e dytë të rendit të ditës.

Kemi nderin dhe kënaqësinë të kemi të pranishëm në komision zëvendësministren, zonjën Albana Shkurta, drejtoreshat Rovenë Beqiraj dhe Alda Klosi, si dhe zotin Gentian Opre, i cili ka bërë mirë që nuk është paraqitur.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Për të mos humbur kohë, unë mendoj që të vazhdojmë menjëherë me trajtimin nën për nen të projektligjit. Besoj se gjatë shqyrtimit mund t’u referohemi edhe propozimeve dhe rekomandimeve që kanë bërë komisionet e tjera parlamentare, sidomos Komisioni i Veprimtarive Prodhuese.

Përpara se të vazhdojmë me diskutimin nën për nen, është e rëndësishme të përsërisim një të vërtetë të madhe për sa i përket ligjit, ndryshimeve, por edhe filozofisë që bazohet e gjithë iniciativa e koncesioneve dhe e partneritetit publik-privat.

E vërteta statistikore është që partneriteti publik-privat si instrument ka ekzistuar gjatë të gjithë periudhës së tranzicionit, sidomos pas vitit 2005. Gjatë viteve 2005-2013 janë bërë 75% e koncesioneve dhe e marrëveshjeve të partneritetit publik-privat. Kjo është një e vërtetë statistikore që referohet kollaj edhe në raportin e fundit të Fondit Monetar Ndërkombëtar. Për t’iu referuar edhe numrave, janë bërë rreth 217 kontrata të partneritetit publik-privat, nga të cilat, rreth 183 janë bërë gjatë viteve 2005-**2018**. Një pjesë e mirë e këtyre kontratave, qoftë në energji, qoftë në shërbime, qoftë koncesione, qoftë partneritet publik-privat, kanë pasur goditje të drejtpërdrejtë ose indirekte në buxhetin e shtetit.

Për ta ilustruar, vetëm nëpërmjet prodhimit të energjisë, me bazë marrëveshjen për blerjen e energjisë, në vitin 2018 prodhuesit e energjisë, koncesionet e viteve 2005-2013, kanë

goditur indirekt buxhetin e shtetit dhe direkt bilancin e OSHE-së me 39 milionë euro. Pra, patjetër që është shtuar kapaciteti i domosdoshëm energjetik i vendit nga i gjithë diskutimi që është bërë për koncesionet në energji, por një të vërtetë financiare duhet ta themi. Mënyrat si janë kontraktuar shit-blerjet e energjisë nga prodhuesit privatë me çmime me prim përtej nivelit të tregut, kanë goditur në vazhdimësi, në kohë të thatë dhe në kohë të lagësht, bilancin energjetik, sidomos në vitin 2018 ku shifra në 10 muaj e parë shkoi në 39 milionë euro.

Më pas, në të gjithë historinë e koncesioneve apo të partneritetit publik-privat shtohet një seri e gjatë me koncesione shërbimesh. Skanimi në doganë është një koncesion tipik ku kostoja i shkon qytetarit dhe biznesit. Për historik dhe për rekord të fakteve, kostoja për një deklaratë ka qenë e negociuar 39 euro. Nga kalkulimet që bëmë ne në vitin 2013 kjo kosto falimentonte një nga sektorët që ofron punësim të gjerë, industrinë fasone apo përpunimin aktiv. Për këtë arsye, buxheti i shtetit merrte një goditje vjetore prej 19 milionë dollarësh. Ndërkohë ne negociuam me koncesionarin për uljen e koston së deklaratës nga 39 euro në 22 euro.

Ndërkohë, pas vitit 2013, partneriteti publik-privat u fokusua te shërbimet. Shembull pozitiv për t'u referuar janë kontratat e partneritetit publik-privat në shëndetësi, ku marrin shërbim njerëz në nevojë, të sëmurë apo pacientë që kanë nevojë për shërbime sa më afër shtëpisë. Të gjithë qytetarëve që kanë nevojë të bëjnë dializën ky shërbim u është ofruar më afër shtëpisë dhe është përballor nga buxheti i shtetit. E njëjta gjë ndodh edhe me *Check up-in*. Ministria e Financave ka bërë në vazhdimësi një detajim shumë të rëndësishëm të kostove dhe përfitimeve, por për këtë maxhorancë shëndeti publik është i paçmueshëm.

Duke iu referuar standardit të Shërbimit Kombëtar të Shëndetit në Britani, standard që është vënë ndërkombëtarisht, por edhe parandalimit, përfitimet financiare gjithashtu janë të rëndësishme. E theksoj, për këtë maxhorancë dhe për këtë qeveri shëndeti publik është i paçmuar.

E njëjta gjë mund të thuhet për sterilizimin, për mbetjet urbane, si dhe për kontratën e partneritetit publik-privat për Rugën e Arbrit, që sot është shembulli i një pune dhe i realizimit të një ëndrre. Është shembulli më i mirë se si një qeveri dhe se si një maxhorancë, nëpërmjet instrumentit të partneritetit publik-privat, i afron ëndrrën shumë e shumë vjeçare popullit të Dibrës për t'u lidhur me një rrugë të qenësishme me kryeqytetin, tregun dhe në një fazë të dytë pse jo edhe me rajonin.

Kontrata për Rugën e Arbrit është shembull se si një instrument investimi, siç është kontrata e partneritetit publik-privat apo koncesionet, mund t'ia ndryshojë jetën një rajoni të tërë.

Të gjithë demonizimit që është tentuar t'i bëhet partneritetit publik-privat ...

Unë mund t'i referohem me një konkluzion me disa pika.

Së pari, askush nuk mund të ketë legjitimitetin të dalë publikisht dhe t'u privojë qytetarëve të Dibrës të drejtën për të pasur atë rrugë që kanë ëndërruar, të cilën ia bëri dhe po ia bën kjo maxhorancë, kjo qeveri; të drejtën universale për t'u shërbyer qoftë atyre që kanë nevojë për dializë, qoftë atyre që, në nevojën dhe fatkeqësinë e ditës, përfundojnë në spital për t'u shërbyer me mjete të sterilizuara, me standarde ndërkombëtare, qoftë qytetarëve që kanë nevojë për *check up* për të parandaluar çdolloj sëmundje të mundshme, qoftë qytetarëve që kanë nevojë të kenë një ambient të pastër. Pra, kjo është pjesa e ofrimit të shërbimeve, mallrave dhe investimeve publike.

Nga ana tjetër, është elementi financiar. Është thënë që kontratat e partneritetit publik-privat kanë risqe. Patjetër që çdo investim publik ka riskun e tij dhe për këtë ju kemi sjellë shembullin e rrugës Tiranë – Elbasan, së cilës iu rrit kostoja afërsisht me 45% nga tenderimi. A nuk ishte risk ky 45%-shi për shkak të keqmenaxhimit, të keqtrajtimit të projektit që në momentin e parë apo të hapjes së tunelit me nxitim? Sigurisht që ishte. Është detyra e administratës që ta negociojë mirë kontratën e partneritetit publik-privat, të vendosë elemente, të cilat garantojnë dhe sigurojnë buxhetin e shtetit nga detyrime kontingjente në të ardhmen dhe nëpërmjet ligjit organik të buxhetit të garantojë në total të gjithë kuadrin fiskal duke mos e lejuar qeverinë, madje asnjë qeveri, që të kalojë 5%-shin e të ardhurave të vitit të kaluar, pra si standard fiskal dhe financiar, ndërkohë që ky nivel është ende vetëm tek 3%-shi dhe besoj se do të rrijë gjatë nën nivelin e rehatshëm të 4%-shit.

Ndryshimet që, siç i kemi theksuar, vijnë këtu nga qeveria, e përmirësojnë kuadrin ligjor duke hequr propozimet e pakërkuara për një sërë shërbimesh dhe kontratash në infrastrukturë, duke filluar nga 1 korriku i vitit 2019 dhe, po ashtu, sigurojnë rolin e Ministrisë së Financave në aspektin e monitorimit fiskal dhe një sërë elementesh të tjera procedurale, duke përfshirë pastaj edhe detyrimin e administratës për të filtruar, në bazë të prioritetëve, të gjitha projektet e mundshme të partneritetit publik-privat me një, nëse mund t'i referohem kështu, komitet të përbashkët

ndërministror me pesë funksione, por që sot janë ende tri ministri dhe mund të jenë kështu për një kohë të gjatë.

Në parim, për sa i përket studimit që unë u kam bërë propozimeve të komisioneve të tjera në respekt të tyre, unë do t'i kërkoja Komisionit të Ekonomisë që ne të mos tutemi nga kërkesa që ka sjellë Këshilli i Ministrave, por ta mbështesim kërkesën që ka sjellë Këshilli i Ministrave këtu në këtë ligj, që përtej datës 1 korrik të vitit 2019 të mos ketë propozime të pakërkuara në infrastrukturë dhe një sërë shërbimesh të tjera. Kjo është shumë e rëndësishme. Komisionet e tjera kanë kërkuar shtyrje ose moratorium, ndërkohë që unë u kërkoj të gjithë anëtarëve të komisionit, sepse kjo është një nga shtyllat e ndryshimeve që ka sjellë Këshilli i Ministrave, me modesti, politikisht, që ta mbështesim këtë qëndrim të Këshillit të Ministrave.

Ndërkohë, mund të kemi propozime të tjera për ta përmirësuar kuadrin në drejtim të kufizimit të ofertave të pakërkuara, duke i vënë një tavan kohor, le ta diskutojmë, ndoshta vitin 2020 ose vitin 2021.

Fillojmë me shqyrtimin nen për nen.

Neni 1. Ka ndonjë koment? Ka pyetje për zëvendësministren dhe për drejtoreshat?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Urdhëroni, zonja Mesi!

Senida Mesi – Përshëndetje të gjithëve!

Në fakt, vlejnë për t'u përgëzuar të gjitha ndryshimet në lidhje me sa përshkruan ligji, në lidhje me sa u diskutua, por ligji përkufizon edhe përcaktimin e disa strukturave të reja, siç është, le të themi, veprimi ndërmjet Agjencisë së Trajtimit të Koncesioneve, Agjencisë së Prokurimit Publik, Komitetit të Përzgjedhjes së Koncesioneve dhe Komisionit të Koncesionit.

Në shumë raste Njësia e Trajtimit është dhe duhet të ndërrohet në emrin “Agjencia e Trajtimit të Koncesioneve”, pra nga “njësi” në “agjenci”, ndërkohë që shoh në disa nene se lihet përsëri fjala “njësi”. Ndaj duhet ta ndërmarrim ne, zoti kryetar, dhe ta shohim edhe nen për nen me ndryshimet përkatëse.

Unë dua të di nga zëvendësministrja, se si këto katër institucione e koordinojnë punën me njëri-tjetrin dhe cilat janë funksionet e njërit institucion përkundrejt tjetrit. A mos ka mbivendosje të funksioneve, për shembull, të Komisionit të Koncesionit, komitetit të përzgjedhjes ose Agjencisë së Trajtimit të Koncesioneve?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kjo ishte pyetja e parë.

Së dyti, dua të pyes për propozimin ligjor që ju keni sjellë. A ka menduar Ministria e Financave dhe Ekonomisë për forma të tjera të koncesionit, sikurse është *BOT (build, operate,*

transfer), që është një nga metodat e tjera të koncesionit (ku përfshihet pjesa e ndërtimit, operacionit, zhvillimit të aktivitetit dhe pjesa e transferimit), apo elementi tjetër *DBO* (*design, build, operate*), ku vetë kompania merr përsipër pjesën e dizenjimit dhe përgatitjes së fizibilitetit, ndërtimin dhe operimin? Këto janë forma të mirënjohura dhe të pranuar edhe nga Banka Botërore, por që në Shqipëri forma të tilla nuk kanë gjetur ende vend në mënyrë të zgjeruar, me qëllim që, nga njëra anë, jo vetëm qeveria, po edhe Republika e Shqipërisë të minimizojnë dhe të largojnë riskun nga Ministria e Financave, nga pjesa e buxhetit, por ngarkon më së shumti edhe kompaninë, e cila e merr koncesionin, me qëllim që të rrisë performancën.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Pyetja e tretë që kam lidhet me të gjitha koncesionet...

Arben Ahmetaj – Më falni, mund të bëj një sqarim?

Besoj se jemi te shqyrtimi nen për nen, ndaj do të sugjeroja që kur të vijmë te nenet përkatëse, meqenëse e kemi kaluar në parim, t'i bëni pyetjet në nenet përkatëse.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Senida Mesi – Faktikisht, pyetja e dytë është në përgjithësi me qasjen që do të ndjekë ministria në lidhje me pjesën e koncesioneve, pra nuk ka të bëjë me shqyrtimin nen për nen.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Megjithatë, nëse duam të kalojmë nen për nen...

Do të doja një përgjigje edhe nga zëvendësministrja...

Arben Ahmetaj – Patjetër që po.

Senida Mesi – ... në lidhje me qasjen, në lidhje me koncesionet.

Arben Ahmetaj – Patjetër.

Faleminderit!

Ka ndonjë koment për nenin 1?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Pyetja e zonjës Mesi ishte zëvendësim i fjalës “njësi” kudo në tekst me fjalën “agjenci”, apo jo, zonja Mesi?

(Deputetja Mesi ndërhyr pa mikrofon.)

Ju kërkoj ndjesë, por nuk e di ku konsiston pyetja. Unë besoj se është e qartë.

Senida Mesi – Të sigurohem se në çdo nen të bëhen ndryshimet.

Arben Ahmetaj – Ah, dakord, e keni në aspektin e teknikës legislative.

Senida Mesi – Po, nga ana e teknikës legislative, asgjë tjetër.

Arben Ahmetaj – Patjetër.

Senida Mesi – Të sigurohemi që neni 1 aplikohet me të vërtetë në të gjitha nenet vijuese.
Kaq.

Arben Ahmetaj – Domosdoshmërisht.

Faleminderit!

Neni 2. Germa “j” e pikës 1 të këtij neni shfuqizohet.

Ka ndonjë koment?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nga ana procedurale, hedhim në votim nenin 1, që ta quajmë të miratuar.

Kush pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Faleminderit!

Neni 2. Germa “j” e pikës 1 të këtij neni shfuqizohet.

Ndonjë pyetje? Nuk ka. Ndonjë koment? Nuk ka.

Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 3 ndryshon si më poshtë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ka ndonjë koment nga kolegët? Në fakt, këtu ka disa komente për sa i përket teknikës legislative.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Atëherë, po i përmend unë dhe besoj se komisioni...

Në nenin 3 të projektligjit sugjerohen ndryshimet e mëposhtme: “Në pikën 2, me qëllim unifikimin e dispozitës për përcaktimin e ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor”, të ndryshuar”, sugjerohet që pas togfjalëshit “koncesion i partneritetit publik-privat (PPP)” të shtohen fjalët “si dhe çdo ndryshim apo transferim i tyre”. Në këtë mënyrë kjo dispozitë do të jetë në të njëjtën linjë edhe me nenet 14 dhe 15 të projektligjit.

Në pikën 7, për shkak të teknikës legislative, sugjerohet që togfjalëshi “ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Më falni?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Është neni 3, që i referohet nenit 10, me pikat përkatëse.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, jemi te neni 3.

(Diskutime në sallë)

Po më ndiqni tani, zoti Sinaj?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në rregull.

Në pikën 7, për shkak të teknikës legjislativë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk e keni aty? Në rregull.

Në pikën 7 thuhet: “Ministri përgjegjës për Financat përgatit një raport vjetor të përmbledhur për ecurinë e kontratave aktive të koncesioneve dhe të PPP-ve, si aneks i raportit vjetor të zbatimit të buxhetit, në përputhje me ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar””. Pra, vetëm për efekt të teknikës legjislativë, sugjerohet që togfjalëshi “ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” të zëvendësohet me fjalët “me legjislacionin në fuqi për menaxhimin e sistemit buxhetor”, që është pak më i gjerë.

Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 4. Këtu ka disa konstatime që kanë të bëjnë me terminologjinë.

Në pikën 2 të nenit 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2016, të ndryshuar, jepet përkufizimi i termit “kontratë publike”: “Kontratat publike” janë kontratat me shpërblim, të lidhura nëpërmjet shkëmbimit të komunikimit me shkrim, ndërmjet një apo më shumë operatorëve ekonomikë dhe një ose më shumë autoriteteve kontraktore, që kanë si objekt kryerjen e punimeve, furnizimin e mallrave dhe shërbimeve, në përputhje me këtë ligj”. Pra, ka një diskutim, por unë besoj që nga stafi i komisionit dhe nga Shërbimi Legjislativ për sa u përket kontratave publike do të thotë se përjashtimi është shumë më i gjerë se sa përjashtimi që ka pasur ligji.

A ka ndonjë koment nga kolegët lidhur me këtë pikë? Dua t’ju kujtoj se kjo pikë në ligjin aktual ka qenë: “Përjashtoni operatorët ekonomikë sipas dispozitave të ligjit të prokurimit publik nga pjesëmarrja në procedurat e koncesioneve dhe partneriteteve publike-private”, pra ka qenë pak më e ngushtë.

A ka ndonjë mendim nga kolegët?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Propozohet që përjashtimi të mbetet siç ka qenë, pra jo siç e ka sjellë qeveria, pra pak më të gjerë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Është shërbimi ligjor këtu.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Neni 4...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po.

Albana Shkurta – A ka mundësi edhe një herë, ju lutem, pasi nuk e kemi përpara propozimin në fjalë?

Arben Ahmetaj – Besoj se ju janë dërguar edhe me *e-mail*. Megjithatë, po i lexoj të dyja versionet, siç ka qenë dhe si është sjellë nga qeveria, për të marrë pastaj vendim.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

“b) Përjashton një operator ekonomik, sipas dispozitave të ligjit të prokurimit publik nga pjesëmarrja në procedurat e koncesioneve, partneriteteve publike-private”. Ndërkohë, në nenin 4, që u referohet ndryshimeve të nenit 11, thuhet: “Përjashton një operator ekonomik, sipas dispozitave të ligjit të prokurimit publik”, deri këtu është e njëjta gjë, duke vijuar “...nga përfitimi i kontratave publike”. Pra, sot është nga pjesëmarrja në procedurat e koncesioneve...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, por kanë shumë kuptim, sepse togfjalëshi “kontrata publike” është shumë më i gjerë sesa thjesht “kontratat koncesionare”.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po.

Është një diskutim ndërmjet vërejtjes që bën Shërbimi Juridik i Kuvendit dhe asaj që...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po.

(Deputeti Angjeli ndërhyr pa mikrofon.)

Jo, Komisioni i Ligjeve nuk ka asnjë koment për këtë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po jua lexoj edhe argumentimin që pastaj të vendosim.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

“Kontratat publike” janë kontratat me shpërblim, të lidhura nëpërmjet shkëmbimit të komunikimit me shkrim, ndërmjet një apo më shumë operatorëve ekonomikë dhe një ose më shumë autoriteteve kontraktore, që kanë si objekt kryerjen e punimeve, furnizimin e mallrave dhe shërbimeve, në përputhje me këtë ligj”. Pra, koncepti “kontratë publike” është shumë më i gjerë se sa “kontratë koncesionare” ose “kontratë partneriteti publik-privat”.

Ligji aktual e ka të ngushtë konceptin dhe fokusohet vetëm te kontratat koncesionare të partneritetit publik-privat, ndërsa ndryshimi i propozuar e sjell më të gjerë konceptin e kontratës publike.

I sugjeroj komisionit, meqenëse ligji ka si objekt koncesionet dhe PPP-të, të kthehemi te përkufizimi i parë, sepse në finale, le të themi, agjencia ose entitetet e prokurimit publik e kanë të drejtë të tyren nëpërmjet ligjit bazë.

Ka ndonjë koment nga ana juaj?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Albana Shkurta – Dua të bëj një sqarim të vogël.

Në fakt, ky propozim nga ana jonë është në linjë me rekomandimin që ka bërë Agjencia e Prokurimit Publik, sepse prek pikërisht kompetencën e kësaj agjencie, e cila, në rastin e konstatimit

të një shkeljeje procedurale të ligjit të prokurimit për kontratat publike, ka detyrimin t'i përjashtojë operatorët ekonomikë nga procedurat e tjera të koncesionit ose të prokurimit publik.

Në kushtet e formulimit ekzistues të ligjit, përjashtohen vetëm kontratat e koncesionit...

Arben Ahmetaj – Po.

Albana Shkurta – ...ndërkohë që Agjencia e Prokurimit Publik rekomandon që gama të zgjerohet. Pra, në qoftë se një operator ekonomik bën shkelje procedurale gjatë një procedure koncesionare, të përjashtohet edhe nga kontratat e tjera të prokurimit publik, pra nga e gjithë fusha e prokurimit publik.

Arben Ahmetaj – Dakord, por propozimi ka kufizim kohor?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

E përjashton përgjithmonë?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Çfarë domethënë?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Më falni, një sekondë!

Albana Shkurta – Kufizimi është me afat të përcaktuar.

Arben Ahmetaj – Sa?

Albana Shkurta – Në përputhje me ligjin e prokurimit publik, kjo është në varësi të shkeljes. Pra, i konstaton rast pas rasti.

Arben Ahmetaj – Në qoftë se...

Albana Shkurta – Maksimumi është tre vjet, por varion nga një vit në tre vjet, në varësi të shkëljes që është bërë nga operatori ekonomik gjatë procedurës konkurruese.

Arben Ahmetaj – Pra, Agjencia e Prokurimit Publik e ka kërkuar këtë ndryshim në këtë nen për ta zgjeruar gamën në bazë të tagrit që ka për ta zgjeruar përjashtimin, jo thjesht brenda kontratave të partneritetit publik-privat.

Në fakt, bën sens, sepse në qoftë se një operator ka shkelur procedurën, nuk ka pse një operator tjetër, i cili nuk është duke garuar në koncesion ose në partneritet publik-privat, të përjashtohet nga të gjitha kontratat publike, ndërsa ai që është brenda partneritetit publik-privat ose koncesionit të përjashtohet vetëm nga kaq ngushtë. Unë besoj se është shumë e qartë. Duhet të ndjekim standardin që ka kërkuar Agjencia e Prokurimit Publik që të përjashtohen nga të gjitha kontratat publike.

Për ta thjeshtuar, çfarë thotë sot ligji aktual “Për koncesionet dhe partneritetin publik-privat”? Thotë: nëse ke shkelur një procedurë për koncesionet apo për partneritetin publik privat, përjashtohesh nga pjesëmarrja në procedurat për koncesionet apo ato për partneritetin publik-privat. Shkeljet janë të detajuara në ligj, ndërkohë që në ligjin për prokurimin publik thuhet se, nëse një operator ka shkelur procedurën, përjashtohet nga të gjitha. Ajo që po bëjmë është që po e standardizojmë, se në finale edhe partneriteti publik-privat, edhe koncesionet janë prokurim publik dhe besoj se është e saktë kjo që ka sjellë ministria, sepse ajo e standardizon.

Blerina Gjylameti – Kryetar,

Nëse do të duhet të bëjmë edhe një referencë të ligjit për prokurimin publik këtu. Atëherë, të vihet sipas dispozitave të ligjit për prokurimin publik me numrin përkatës.

Arben Ahmetaj – Urdhëroni, zoti Angjeli!

Anastas Angjeli – Unë jam dakord me këtë qëndrim, por kam një pyetje për ekspertët. Kur ka kaluar ligji në qeveri, kur e keni qarkulluar në sistem, agjencia a është prononcuar? A e ka dhënë këtë mendim atëherë dhe cili është mendimi juaj? Pse e keni sjellë kështu? Pse e ndryshuat mendimin tani dhe jo atëherë?

Arben Ahmetaj – Ministria nuk e ka ndryshuar mendimin, zoti Angjeli, por ka bërë një vërejtje dhe komisioni ynë. Ministra vazhdon t’i qëndrojë variantit, që ka sjellë.

Anastas Angjeli – Në rregull.

Arben Ahmetaj – Atëherë, me vërejtjen që kishte zonja Gjylameti, duke iu shënuar edhe numri i ligjit...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Patjetër, urdhëroni!

Ismet Beqiraj - Për sa kohë përjashtohet ai, kur e konstaton agjencia edhe për sa kohë përjashtohet? A ka një limit kohor?

Arben Ahmetaj - Pra, agjencisë i është dhënë e drejta në standard edhe në këtë ligj që ta përjashtojë nga procedurat për 1-3 vjet.

Pra, është e përcaktuar në kohë.

Atëherë, kush është pro me shtesën që bëri zonja Gjylameti për t'iu referuar nenit konkret?

Urdhëro Albana!

Albana Shkurta – Nëse më lejohet, duke pasur parasysh që në nenin e mëparshëm ne bëmë një ndryshim që i referohet heqjes së referencës ekzakte në ligj...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Arben Ahmetaj - E qartë. Pra, nuk bazohet vetëm në ligjin për menaxhimin buxhetor, por në të gjithë legjislacionin kuadër.

Albana Shkurta – Pikërisht. Duke menduar që mund t'i qëndrojmë...

Arben Ahmetaj - Shumë e drejtë. Të mbajmë të njëjtin standard. Nuk besoj të kemi ndonjë kundërshtim.

E qartë. Pra, le t'u referohemi dispozitave të ligjit për prokurimin publik.

Kush është pro? Kush është kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 4.

Vazhdojmë me nenin 5.

Ka ndonjë koment apo ndonjë pyetje për këtë nen? Nuk ka.

Kush është pro? Kush është kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 5.

Vazhdojmë me nenin 6. Ka ndonjë koment apo ndonjë pyetje për këtë nen?

Urdhëro, Ismet!

Ismet Beqiraj – Edhe kur e kemi diskutuar në parim, unë e kam shprehur mendimin tim. Meqenëse përzgjedhja e projekteve të koncesionit dhe të PPP-ve ka një sensibilitet jo vetëm politik, por edhe publik, komisioni i përzgjedhjes së projekteve duhet të jetë më i gjerë dhe unë kam bërë 1 propozim dhe i mbetem këtij propozimi. Do ta jap edhe me shkrim propozimin: pjesëmarrja publike në këtë organizëm, jo vetëm që është e domosdoshme, por duhet të përfaqësohet me potencialet intelektuale të botës akademike, sipas fushave, rast pas rasti të koncesioneve dhe të PPP-ve që jepen për sektorë të ndryshëm të ekonomisë. Më konkretisht, ky është edhe koment, edhe argumenti për këtë punë që u mbështet edhe nga kolegët e tjerë gjatë diskutimit në parim.

Unë propozoj që pika 2, e nenit 6, aty ku shtohet neni 12/1, pas fjalëve “komiteti shqyrton rast pas rasti pa të drejtë vote”, të shtohet togfjalëshi: “përfaqësues nga bota akademike, si...”. Më tej vijon me fjalët e tjera të kësaj pike.

Arben Ahmetaj – Më falni!

Ismet, a mund ta lexoni pikën 3 të nenit, sepse kjo pikë e afron këtë mundësi edhe më gjerë. “Komiteti shqyrton dhe miraton kërkesat e autoriteteve kontraktore për mbështetjen me ekspertizë të specializuar për hartimin e studimit të fizibilitetit të projekteve të mundshme të koncesionit/PPP.” Komiteti është organ administrativ kolegjal.

Ismet Beqiraj – Pika 3...

Arben Ahmetaj – Ta mbaroj të lutem!

Ismet Beqiraj – Jo, unë e kam lexuar me shumë vëmendje dhe nuk hyj... Sigurisht, përfaqësuesit e ministrisë nuk janë specialistë të të gjitha fushave, si për shembull të sektorit të energjisë, kur jepet një koncesion. Kjo bëhet nëpërmjet ekspertëve të fushës dhe ka të bëjë me një ekspertizë e specializuar, ndërsa përfaqësuesit e botës akademike të fushave përkatëse në këtë komision, ne nuk mund ta lëmë një komision të diskutohet, sepse në finale diskutohet për taksat e qytetarëve shqiptarë, ka të bëjë me transparencën për të përfaqësuar publikun.

Arben Ahmetaj – Ismet, e kuptova.

Ismet Beqiraj – Në këtë aspekt ekspertiza e specializuar nuk e mbivendos këtë propozim, përkundrazi e bën më të hapur në mënyrë që ky komision të mos jetë thjesht një komision brenda kornizës burokratike politikëbërëse.

Arben Ahmetaj – Më fal!

Komiteti i përzgjedhjes është një organ administrativ, që përfaqësohet nga autoritete shtetërore, nuk është një organ konsultativ.

Pika 3 thotë: “Komiteti shqyrton dhe miraton kërkesat e autoriteteve kontraktore për mbështetjen me ekspertizë të specializuar për hartimin e studimit të fizibilitetit të projekteve ...” Kjo do të thotë që gama për të ftuar specialistë nga akademja, nga bota akademike, nga profesione të ndryshme, apo nga urdhrat e ndryshme, është shumë e gjerë. Pra, ia ka dhënë mundësinë.

Le t’i ndajmë trupat. Komiteti i përzgjedhjes është një organ administrativ shtetëror, që përbëhet nga ministrat përgjegjës.

Komiteti kur shqyrton dhe miraton kërkesat e autoriteteve në referencë të prioriteteve, mund të thërrasë një gamë të gjerë specialistësh nga e gjithë bota, nga të gjitha fushat e ekspertizës, si në energji, shëndetësi, infrastrukturë, hidroenergji etj. Pra, besoj se pika 3 e mbulon gjerësisht këtë kërkesë të drejtë tuajën.

Ismet Beqiraj – Edhe një herë, unë mbetem fort në këtë argument, sepse pika 3 është asistencë oponente, shkencore në vendimmarrjen e kalimit të projektit. Sigurisht, përfaqësuesit e ministrisë janë politikëbërës dhe nuk janë specialistë të të gjitha fushave. Po publiku ku përfaqësohet?

Pjesëmarrja e këtyre me togfjalëshin “pa të drejtë vote”, është një pozicion honorifik për dhënie mendimi dhe nuk futet në kornizën e një komisioni administrativ shtetëror.

Arben Ahmetaj – Pra, për të qenë të qartë, propozimi juaj është të futet një anëtar nga bota akademike pa të drejtë vote?

Ismet Beqiraj – Po, ashtu siç janë futur edhe titullarët e autoritetit kontraktor rast pas rasti, pa të drejtë vote, të futen edhe përfaqësues nga bota akademike, aq sa të jenë të nevojshëm politikëbërësit. Pra, kjo është ideja.

Arben Ahmetaj – Pra, për të qenë të qartë, ju propozoni që në komitet të futen rast pas rasti, titullarë të autoritetit kontraktor dhe përfaqësues nga bota akademike pa të drejtë vote. Kjo është?

Ismet Beqiraj – Po, komiteti fton rast pas rasti përfaqësues nga bota akademike pa të drejtë vote, si dhe titullarë të autoritetit kontraktor.

Arben Ahmetaj – Dakord. Togfjalëshi “nga bota akademike” të jetë i spostuar në fund.

Ismet Beqiraj – Po, komiteti fton rast pas rasti përfaqësues nga bota akademike si...”.

Arben Ahmetaj – Dakord. Propozim shumë i drejtë.

Faleminderit!

Urdhëroni!

Anastas Angjeli - Kur e diskutuam në parim radhën e kaluar, thamë që nenet 6 dhe 7 do t’i shikonim edhe një herë për përputhshmërinë ligjore dhe kushtetuese, për sa u përket funksioneve të ministrave, sepse duke e formuluar në këtë mënyrë është supozuar se si mund të jenë ministrat dhe jo si janë. Nuk e di se ç’mendim kanë ekspertët, a folën në Komisionin e Ligjeve apo jo.

Arben Ahmetaj – Po, folën. Komisioni i Ligjeve është i mendimit se është e qartë siç është vendosur këtu, sepse ministrat në formatin e tyre mund të ndryshojnë sipas rastit që do të kërkojë Kryeministri Rama edhe në mandatin e tretë, ndërkohë që funksionet mbeten të njëjta.

Anastas Angjeli - Dakord, por ekspertët t’ia marrin me shkrim Komisionit të Ligjeve, sepse herën e kaluar këtë çështje e ngriti edhe zoti Haxhinasto.

Arben Ahmetaj – Patjetër.

Arben Ahmetaj – Më falni! Ky komision nuk është në funksion të Komisionit të Ligjeve.

Anastas Angjeli - Më falni!

Kur ky komision kur ka pikëpyetje për çështje ligjore dhe kushtetuese, nuk është më në funksion të askujt, por merr mendimin me shkrim të Komisionit të Ligjeve, që të jemi në rregull.

Arben Ahmetaj - Patjetër.

Po ju marr një rast konkret, që të ndjekim të drejtën procedurale. Po marr si shembull Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë. Sot janë 2 funksione të mëdha brenda të njëjtit format administrativ dhe kushtetues, siç është kjo ministri. Nesër, në mandatin e tretë mund të ndahet dhe mund të bëhet veç Ministria e Infrastrukturës dhe veç Ministria e Energjisë. Ne nuk do të ndryshojmë ligjin.

Pse do të ndryshojmë ligjin, kur ka një mënyrë më të mirë për ta shprehur kur mund të thuhet: ministri përgjegjës për çështjet e Infrastrukturës, dhe ministri përgjegjës për çështjet e Energjisë dhe industrisë. Pra, u referohet funksioneve dhe nuk u referohet më ministrive.

Anastas Angjeli – Po, por ka një problem. Aktualisht, nuk është funksional kështu, siç e kemi propozuar ne komisionin, sepse kemi një ministër që i ka të tri këto pika përgjegjësie.

Arben Ahmetaj – Po ky nuk është një problem ...

Anastas Angjeli – Ose të vihet këtu që në raste të tilla i delegohet, ku e di unë, zëvendësministrit ose kryetarit të shtetit.

Arben Ahmetaj – Jo, se e kemi thënë ndryshe: komisioni...

Anastas Angjeli – Ky është me dy fusha tani, nuk është me pesë ose me gjashtë.

Arben Ahmetaj – Jo, është me tre. Pika 4 thotë: “Komiteti miraton me vendim rregulloren për mënyrën e funksionimit të tij dhe kriteret për vlerësimin e kërkesave të ...” Kjo do të thotë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Më falni!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, po ta shikoni...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Më falni!

Unë sugjeroj këtë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

E drejtë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Patjetër.

Pjerin Ndreu - Meqenëse ministritë mund të ndahen apo të bashkohen, mendoj të vihet: ministrat përgjegjës për 1-2-3-4, jo: ministri përgjegjës për këtë apo për atë se i bie të përmendet 2 herë i njëjti ministër.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po e the shumë, pastaj mund të ndodhë që...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ky është propozimi im.

Arben Ahmetaj – Më falni!

Unë mendoj të gjejmë një zgjidhje të kësaj natyre. Për mendimin tim, është e qartë, megjithatë secili nga anëtarët e komisionit ka mendimin e vet. Mund të shtojmë një pikë, ku të themi: mënyra e funksionimit të komitetit përcaktohet me VKM dhe Këshilli i Ministrave nxjerr një vendim. Dakord?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në rregull?

Po, Antoneta.

Antoneta Dhima – Faleminderit, zoti kryetar!

Unë doja të bëja një pyetje për ekspertët: a keni ju një model? Kujt i jeni referuar për këto ndryshime? Së dyti, te pika 1 thuhet, midis tjerash: organi administrativ kolegjal, i cili kryesohet nga ministri përgjegjës për ekonominë, dhe në përbërje të tij janë... Mund të bëhet: “koordinohet”, sepse sipas koncesioneve që do të jepen, ministrat mund të jenë përgjegjës. Në qoftë se është një koncesion për infrastrukturën, duhet të jetë ministri i Infrastrukturës. Ky është gjykimi im.

Arben Ahmetaj – Ka një argument, dhe ky ka qenë diskutim edhe kur është shkruar ligji. Në finale, ka qenë ministria e Ekonomisë përgjegjëse për koncesionet, pra, për procedurat, meqenëse edhe ATRAKO ka qenë në vazhdimësi brenda Ministrisë së Ekonomisë. Në finale, është organ administrativ kolegjal. Në këtë rast, kryesimi nuk i jep ministrit të Ekonomisë të drejtën e një vote plus. Ai ose ajo është e barabartë me çdo ministër tjetër. Është edhe kolegjiale.

Pra, çfarë do të bëjë komiteti? Komiteti do të përzgjedhë... Dua të fokusohem për një sekondë te funksioni i komitetit, që të mos bëjmë debat. Çfarë do të thotë kjo? Po marr një rast konkret: në qoftë se kemi hapësirë prej 1 % të të ardhurave të vitit të kaluar, për të bërë koncesione, dhe vijmë dhjetë koncesione, të cilat janë 4 %, ndërkohë që ne kemi vetëm 1, cilat janë koncesionet që do të furnizohen me financim buxhetor? Aty bëhet diskutimi. Diskutimi bëhet për prioritetet e qeverisë. Pasta, sigurisht, ky komitet i referohet Këshillit të Ministrave. Sigurisht, ministrat diskutojnë për prioritetet, dhe në finale, në kolegjialitet, vendoset nëse do të jetë një PPP në shëndetësi, në infrastrukturë apo në ndonjë shërbim tjetër. Është komiteti ai që vendos. Ky është

funkcioni i komitetit. Është një çikë më i thjeshtë dhe bazik, por gjithashtu shumë i rëndësishëm. Kështu që, është kryetar, është koordinator, sa e komplikojmë gjuhën, sepse funksioni do të jetë shumë bazik, funksioni do të jetë përzgjedhja në bazë të prioriteteve, e radhës së koncesioneve të mundshme apo e partneritetit publik privat, në bazë të kërkesave që do të bëjnë autoritetet e mundshme kontraktore.

Evis Kushi – Një propozim, të lutem, që mund ta diskutojmë. Meqenëse patëm shumë diskutime për sa i takon përbërjes së këtij komiteti, mund ta caktojmë te secila pikë ministrin ose zëvendësministrin?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Apo jo? Nuk mund të jenë. Dakord!

Arben Ahmetaj – Po nesër mund të mos ketë zëvendësministra, por ministra do të ketë në bazë të Kushtetutës, të paktën.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Atëherë, e votojmë këtë nen, me shtesën që bëra unë: Këshilli i Ministrave nxjerr VKM për rregulloren dhe funksionimin?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

E shtuam, edhe me ndryshimin që u bë në pikën 2, në referencë të asaj që propozoi Ismeti. Dakord?

Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet!

Vazhdojmë me nenin 7.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Senida Mesi – Pa kaluar te neni 7, që i referohet nenit 16, faktikisht unë kam nevojë për një sqarim në lidhje me dy nenet ekzistuese të ligjit, përkatësisht neni 12 dhe neni 18. Në nenin 12 përcaktohen shumë qartë përgjegjësitë e Agjencisë së Trajtimit të Projekteve të Koncesionit.

Neni 18 përcakton...

Arben Ahmetaj – I ligjit aktual, gjithmonë.

Senida Mesi – Lidhet me nenin 12 të ligjit aktual, por pa kaluar më tutje. Do të doja të sqaroja pak kompetencat. Ligji aktual, neni 12, përcakton shumë qartë kompetencat e Agjencisë së Trajtimit të Koncesioneve dhe Partneritetit Publik Privat.

Ndërkohë, neni 18, që realisht nuk e kemi fare për trajtim këtu, është Komisioni i Koncesionit të Partneritetit Publik Privat. A mund të më sqaroni detyrat e njërit dhe tjetrit, sepse mua më duket se ka mbivendosje. Edhe njëri, edhe tjetri trajton dhe bën plan fizibiliteti. Edhe

agjencia, edhe komisioni përcakton procedura dhe bën vlerësimin e projekteve të propozuara. Në këtë pikë, ku ndryshon agjencia, roli dhe funksioni i agjencisë me Komisionin e Koncesionit?

Arben Ahmetaj – Ka një ndryshim thelbësor. Komisioni është pjesë e procedurës zyrtare të përzgjedhjes, ndërsa ATRAKO e bën në parim vlerësimin për fizibilitetin. Megjithatë, në qoftë se...

Senida Mesi – Po t’i referohem pikë për pikë, ndoshta drejtoreshat mund të jenë më të sakta, pra po t’i referohem pikë për pikë, thuhet: “Agjencia e Trajtimit të Koncesioneve dhe Partneritetit Publik Privat bën përgatitjen e studimit të fizibilitetit, përgatit dokumentacionin, bën vlerësimin e propozimeve, kryen procesin e negociimeve, nënshkruan marrëveshje dhe bën monitorimin e kontratave të koncesionit.”

Kalojmë te neni 18, për pjesën e Komisionit të Koncesionit, që ka përbërje teknike, dhe jo si më lart, që është agjenci. Pika 5 e nenit 18 thotë: “Komisioni i Koncesionit të Partneritetit Publik Privat ka këto detyra: harton studimin e fizibilitetit, shqyrton dhe vlerëson ofertat, formulon propozimin dhe kryen të gjitha aktivitetet e tjera që kërkohen, në zbatim të procedurës së koncesionit, në përputhje me rregulloren në fuqi.”

Domethënë, pikat a, b dhe c, minimalisht janë identike me detyrat dhe funksionet e agjencisë në nenin 12.

Arben Ahmetaj – Dakord, Senida, por neni 18 ka një diferencë shumë të madhe. Jemi duke folur për procedurën zyrtare tashmë. Nuk jemi duke folur në parim, siç është momenti i agjencisë, por jemi duke folur për procedurën zyrtare. Në qoftë se është e pakërkuar si ofertë, komisioni, pasi ka vlerësuar ofertën...

Senida Mesi – Nuk kemi më oferta të pakërkua, sepse e hoqe me këtë ndryshim.

Arben Ahmetaj – Jo, do të kemi.

Senida Mesi – Në një pjesë.

Arben Ahmetaj – Në një pjesë do të kemi se s’bën. Administrata, ose më mirë komisioni, bën atë që quhet pronësimi i projektit, për ta hedhur në tender, sepse kur hidhet në tender nuk ka

më profilin e një oferte të pakërkuar, por është kthyer në një dokument zyrtar shtetëror. Komisioni e përgatit në bazë të vlerësimit dhe dokumenteve të tenderit.

Senida Mesi – Unë kam nevojë për një sqarim.

Arben Ahmetaj – Në këndvështrimin tim është shumë e qartë, por gjithsesi, ju lutem, bëni një sqarim, Rovenë.

Rovena Beqiraj – Në fakt, me këtë ligj, Agjencisë së Trajtimit të Koncesioneve kanë ndryshuar vetëm për sa i përket Komitetit të Përzgjedhjes, por le të sqarojmë më parë kompetencat e Agjencisë së Koncesioneve me komitetin. Agjencisë së Trajtimit të Koncesioneve ose ATRAKO, siç njihet gjerësisht, asiston të gjitha autoritetet kontraktore në procedurat e dhënies me koncesion. Asistenca që bën Agjencia e Trajtimit të Koncesioneve është me dy anëtarë, në komitete që ngrihen për çdo projekt. Pra, për çdo projekt, autoritetet kontraktore ngrenë nga një komitet koncesioni dhe PPP-je ad hoc, i cili merr në shqyrtim ose propozimin e pakërkuar, ose në rastin kur është i kërkuar, projektin, dhe bashkërisht me ATRAKO-n bëjnë hartimin e studimit të fizibilitetit, përgatitjen e dokumenteve të garës, kriteret e vlerësimit, përzgjedhjen e operatorëve fitues, negocimin e kontratës.

Pra, ATRAKO është një organ që asiston autoritetet kontraktore gjatë gjithë kësaj procedure. Pra, janë dy organe të ndryshme, të cilat, në fakt, nuk kanë ndryshime të kompetencave. Ndryshimet që sjell ky projektligj janë pikërisht krijimi i Komitetit të Përzgjedhjes së Projekteve, i cili ka një detyrë tjetër. Komiteti i Përzgjedhjes së Projekteve do të përzgjedhë vetëm ato projekte, të cilat do të mbështeten me një ekspertizë të jashtme, me ekspertë të jashtëm, përtej ekspertizës që ofron ATRAKO. Në këtë rast ATRAKO do të luajë rolin e sekretariatit, pra do të facilitojë të gjithë procesin e kërkesave që do të vijnë pranë Komitetit të Përzgjedhjes së Projekteve.

Arben Ahmetaj – Faleminderit!

Ka ndonjë gjë tjetër në lidhje me nenin 7, para se ta hedh në votim?

Kush është dakord me nenin 7? Kundër? Abstenim?

Miratohet!

Neni 8.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Tani që opozita ka kaluar në opozitë, do të na duhet ta bëjmë ne pozitën e opozitës.

Para se të kalojmë në vlerësimin për nenin 8, ka bërë një propozim Komisioni i Veprimtarive Prodhuese. Atëherë, Komisioni i Veprimtarive Prodhuese rekomandon që në nenin 17 të ligjit, pas pikës 2, të shtohet pika 3: “Identifikimi i projekteve të mundshme koncesionare të

partneritetit publik privat, duhet të bëhet duke u mbështetur dhe duke u referuar në strategjitë, planet apo programet sektoriale, ndërsektoriale të nivelit kombëtar, ndërvendor ose vendor, të miratuar si pjesë e sistemit të planifikimit të integruar. Përputhshmëria dhe bashkëvendimi i projektit të mundshëm koncesionar të partneritetit publik privat, me strategjitë, planet apo programet ndërsektoriale e sektoriale, është parakusht për miratimin e tij.”

Çfarë mendimi keni?

Unë e kam një mendim për këtë pikën.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Faleminderit!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Dakord!

Atëherë votojmë nenin 8.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Më falni?

Ja, një sekondë, se kemi edhe një propozim tjetër. Në nenin 17, pas pikës 2, të shtohet 2/1, si më poshtë. Në fakt kanë shtuar edhe pikën 3, edhe pikën... kështu që duhej ta kishin referuar ndryshe.

Pika 1 e nenit 8 dhe pika 1 e nenit 10 mbetet në fuqi deri me datën 31 dhjetor 2021. Pra, Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese thotë:

“Parashikimet për kufizimin e pranimi të propozimeve të pakërkuara, vetëm për realizimin e punimeve dhe ofrimin e shërbimeve në porte, aeroporte, për prodhimin dhe shpërndarjen e energjisë elektrike, energjisë për ngrohje dhe energjisë së gazit natyror, rekomandohet që ky kufizim, në këtë afat, të përcaktohet konkretisht deri më 31 dhjetor 2021.”

Anastas Angjeli – Si është propozimi i projektit që kemi?

Arben Ahmetaj – Propozimi është që operatorët ekonomikë, nëpërmjet propozimeve të pakërkuara vetëm për realizimin e punimeve ose ofrimit të shërbimeve në porte, aeroporte, për prodhimin dhe shpërndarjen e energjisë elektrike, energjisë për ngrohje dhe shpërndarjen e gazit.

Pra, praktikisht, ne kemi hequr propozimet e pakërkuara në infrastrukturë dhe në një sërë shërbimesh, ndërsa propozimi këtu presupozon që të bëhet një moratorium. Ky është thelbi i propozimit.

I sugjeroj komisionit të qëndrojë te heqja përgjithmonë e propozimeve të pakërkuara. Pra, ne do t'i qëndrojmë variantit të qeverisë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po.

Ismet Beqiraj – Sipas variantit të qeverisë, te pika 1 e nenit 8, germa “d”: “Operatorët ekonomikë, nëpërmjet propozimeve të pakërkuara vetëm për realizmin e punimeve në aeroporte....”, si dhe te relacioni bashkëngjitur, këta sektorë, si: porte, aeroporte, prodhimi dhe shpërndarja e energjisë elektrike, energjisë për ngrohje dhe shpërndarja e gazit natyror, mbeten akoma te propozimet e pakërkuara.

Atëherë, sipas konceptit tim dhe argumentimit në relacion, kjo i lë në fuqi propozimet e pakërkuara, që të vazhdojnë. Këtu nuk thuhet të hiqen disa sektorë.

Arben Ahmetaj – Ismet, thelbi i...

Ismet Beqiraj - Kisha pyetje për përfaqësuesit e ministrisë, si dhe një propozim konkret. Duhet të hiqeshin propozimet e pakërkuara.

Arben Ahmetaj – Më falni, te cili sektor?

Ismet Beqiraj – Jo, para se të them mendimin tim, duhet të bëj disa pyetje.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju lutem!

Te sektori i energjisë për ngrohje, cilët keni parasysh? Se është sektor i madh. Ka të bëjë me industrinë e nxjerrjes së naftës dhe të gazit?

Së dyti, shpërndarja e gazit natyror, me cilët ka të bëjë? Ka të bëjë me gazifikimin e Shqipërisë nga masterplani kombëtar?

Na i sqaroni këto dhe unë do të jap mendimin përkatës.

Arben Ahmetaj – Faleminderit!

Kam një sqarim.

Çfarë ka bërë ligji, Ismet? Po i referohem nenit 17 të ligjit ekzistues, ku presupozohet që identifikimi i projekteve të mundshme të koncesionit dhe partneritet publik-privat.... Përpara se ta lexoj, thelbi i ndryshimit, Ismet, për ta sqaruar edhe për publikun, është ky: deri më sot ofertat e pakërkuara kanë qenë të palimituara në çdo sektor dhe shtriheshin në të gjithë sektorët që e ofrojnë këtë mundësi në ligj. Sot ne i kufizojmë, pra ne heqim mundësinë e një oferte të pakërkuar në infrastrukturë dhe në një sërë shërbimesh dhe e kufizojmë ofertën e pakërkuar vetëm në këto pika:

“Operatorët ekonomikë, nëpërmjet propozimeve të pakërkuara, vetëm për realizimin e punimeve dhe ofrimin e shërbimeve në porte, aeroporte, për prodhimin dhe shpërndarjen e energjisë elektrike, energjisë për ngrohje dhe shpërndarjen e gazit natyror.” Pra, ndryshimi është shumë i qartë, janë kufizuar ofertat e pakërkuara. Dakord?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Për cilën pjesë?

Ismet Beqiraj – E bëra pyetjen. Te sektori i energjisë për ngrohje, çfarë përfshihet?

Te shpërndarja e gazit natyror, çfarë përfshini?

Mbi bazën e përgjigjeve tuaja, unë do të jap...

Albana Shkurta – Projektligji, i iniciuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, përpara se të kalonte në Këshillin e Ministrave, është konsultuar me të gjitha ministrinë e linjës. Qëllimi i Ministrisë së Financave ka qenë në përputhje me rekomandimet e institucioneve ndërkombëtare, si: FMN-ja, SIGMA-OECD, Banka Botërore apo Komiteti Europian, për të eliminuar efektet e pakërkuara në pothuajse të gjithë sektorët, që janë fushë e mbulimit të këtij ligji.

Sektorët që janë fushë e mbulimit të këtij ligji janë të shumtë. Kryetari i komisionit sapo i përmendi ata sektorë që do të vazhdojnë të mbeten. Ndërkohë, do të doja...

Ismet Beqiraj – Ju lutem, ma thoni më konkretisht! Sektori i shpërndarjes së energjisë për ngrohje...

Albana Shkurta - Me lejoni të jap një shpjegim, ju lutem!

(Deputeti Ismet Beqiraj flet pa mikrofon)

Arben Ahmetaj – Ismet, ta dëgjojmë zëvendësministren, të lutem!

Ismet Beqiraj - Pse t’i bjerë nga Kina? Ta thotë shqip: “Sektori i energjisë për ngrohje është ky. Shpërndarja e gazi natyror është kjo”.

Arben Ahmetaj – Ismet, më fal, por ne nuk i definojmë dot përgjigjet që japin administratat dhe ministrinë! Prandaj i kemi këtu përfaqësuesit e nderuar.

Ju lutem, zonjë!

Albana Shkurta – Në morinë e sektorëve, që janë pjesë e objektit të këtij ligji, përveç atyre që, siç i përmendi dhe kryetari i komisionit, do të vazhdojnë të mbeten, disa nga sektorët ku nuk do të pranohen më propozime të pakërkuara, janë: infrastruktura; prodhimi dhe shpërndarja e ujit; trajtimi, mbledhja dhe shpërndarja e ujërave të zeza; ujitja; menaxhimi i mbeturinave, duke

përfshirë mbledhjen, trajtimin dhe transferimin e tyre; telekomunikacioni; shkenca dhe arsimi; turizmi; argëtimi; hoteleria; kultura; sporti; shëndetësia e të tjerë.

Në fushat ku ministria përgjegjëse për këta sektorë ka dhënë rekomandimin gjatë konsultimit të këtij projektligji, është shprehur (duke qenë ministria kompetente për këtë fushë) se portet, aeroportet, energjia elektrike dhe energjia për ngrohje, që mund të vijë si pasojë e prodhimit të energjisë, për shembull, nga gazi, si dhe kur gjatë procesit teknologjik të prodhimit të energjisë nga gazi, prodhohet energji për ngrohje, kjo bëhet pjesë e këtij projekti dhe kalon për ngrohjen e një zone të caktuar urbane.

Për sa i përket shpërndarjes së gazit natyror, është në përputhje me strategjinë që ka parashikuar ministria e linjës në paktin e saj, me mënyrën se si do ta bëjë projektin e gazifikimit të Shqipërisë dhe projekte të tjera të kësaj natyre.

Nuk është Ministria e Financave ajo që përcakton se pse janë lejuar pikërisht këto fusha, për të cilat është kërkuar të lejohen propozimet e pakërkuara, por është ministria përkatëse, e cila, për shkak të mungesës së kapaciteteve për të trajtuar këto lloj projektesh, mendon se është e nevojshme që kjo të lejohet ende. Ky është thelbi.

Arben Ahmetaj – Faleminderit!

Ismet Beqiraj - Nuk ma mbushe mendjen!

Arben Ahmetaj – Kërkohet leje në komision, i dashur, që të mos...

Ismet Beqiraj - Kam një propozim. Nuk do të bëj debat.

Arben Ahmetaj - Duhet të flasim me leje, se përndryshe...

(Deputeti Ismet Beqiraj flet pa mikrofon)

Patjetër, por duhet të flasim me leje, që të mos bëjmë kakofoni me njëri-tjetrin. Të lutem!

Ismet Beqiraj – Privatizimeve të sektorëve strategjikë, sidomos atyre të energjisë, si dhe koncesioneve, ua kemi parë hajrin. Qypi i mjaltit i privatizimeve dhe koncesioneve ka mbaruar shpejt. E dimë se çfarë ka ndodhur dhe se si është ky sektor.

Uroj që në sektorin e energjisë për ngrohje të mos jenë vendburimet e naftës dhe të gazit që ka Shqipëria, sepse dhënia me koncesion është një praktikë e dështuar, për arsye se

vendburimet, që janë të papërsëritshme për llojin, potencialin energjik dhe kontributin në buxhetin e shtetit, nuk rivendosen kollaj! Natyra na e ka dhënë këtë dhuratë.

E kuptova që shpërndarja e gazit natyror ka të bëjë me gazifikimin dhe strategjinë që ka qeveria për të, për rrjetin e gazit...

Propozimi im është që nga ky ndryshim i nenit, këta dy sektorë të rëndësishëm të hiqen nga propozimet e pakërkuara.

Arben Ahmetaj – Cilët?

Ismet Beqiraj – Sektori i energjisë për ngrohje dhe sektori i shpërndarjes së gazit natyror. Kam disa argumente për këtë.

Energjia dhe gazi janë produkte që i shërbejnë publikut. Më e keqja është se duke dhënë akoma propozime të pakërkuara, ne krijojmë monopol në treg (duhet ta pranojmë këtë), aq më tepër që energjia dhe gazi natyror janë dy sektorë nevralgjikë.

Nga ana tjetër, shpërdorohen këto asete dhe burime natyrore.

Këta sektorë janë vlerësuar si të rëndësishëm dhe strategjikë. Atëherë, duhet t'i japim me praktika të tilla, me koncesione, sektorët strategjikë?! E thashë, ua kemi parë hajrin koncesioneve.

Ky ishte propozimi im.

Arben Ahmetaj – Për sqarimin tuaj, besoj se populli i Dibrës po ia sheh hajrin rrugës; të gjithë atë që kanë nevojë për dializë, po e shohin shërbimin; ata që u mbytën nga mbetjet kanceroze në Elbasan, në Fier dhe në Tiranë, po e shohin dhe do të vazhdojnë ta shohin hajrin; ata që shkojnë në spital dhe operohen me mjete të sterilizuara, po e shohin hajrin; ata që bëjnë kontrollin falas dhe i paraprijnë ndonjë sëmundjeje të mundshme, po e shohin hajrin.

Nëpërmjet këtyre shërbimeve qytetarët po marrin atë që kanë nevojë në territore të ndryshme dhe në sektorë të ndryshëm.

Jam i bindur se ditën kur do të bashkohet Dibra me Tiranën me rrugën e re, do të shihet hajri për gjithë Shqipërinë dhe nga çdo qytetar.

Kam një sqarim: pusët nuk jepen me koncesion në bazë të këtij ligji. Pusët e naftës kanë një legjislacion specifik, që nuk ka ndryshuar dhe nuk bie në këtë ligj. Arsyeja se pse ne kemi lënë prodhimin e energjisë dhe shpërndarjen e gazit apo të energjisë, qoftë për ndriçim, qoftë për ngrohje, është se ata janë sektorë strategjikë dhe administrata nuk është në gjendje të bëjë oferta të kërkuara në atë masë. Besoj se rritja e kapaciteteve energjetike është e domosdoshme.

Në thelb kemi kufizuar ofertat e pakërkuara. Kjo është në linjë me kërkesën që ka bërë Komisioni Europian, Banka Botërore, Fondi Monetar, SIGMA-OECD, si dhe ne, me punën tonë të përditshme, që kemi arritur në këtë konkluzion.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po.

Më pas do të flasë zonja Gjylameti.

Anastas Angjeli – Kam përshtypjen që po diskutojmë për një çështje shumë parimore. Mundet që kolegu ynë të ketë të drejtë të ngrejë disa shqetësime, që mund të kenë ardhur nga

moszbatimi i disa kontratave koncesionare, por të thuash se ne ua kemi parë hajrin këtyre koncesioneve dhe nuk duhet të kemi më koncesione, më duket pak absurde, sepse ne kemi pranuar atë që bën gjithë bota e ekonomisë së tregut. Kemi tri ligje të tjera: ligjin për koncesionet, ligjin për privatizimin e sektorëve strategjikë, si dhe ligjin për investime në sektorët strategjikë, që njohin format e ekonomisë private dhe të privatizimit të ekonomisë në vendin tonë. Një nga këto forma mund të jetë edhe koncesioni. Kësaj nuk i kthehem dot mbrapa. Të kthehesh mbrapa, nga një formë ekonomie private, në të gjitha format e saj: privat, koncesion apo çfarëdo qoftë, te prona shtetërore, kjo nuk mund të bëhet!

Të rregullosh me ligje mbikëqyrjen dhe mirëfunksionimin atje ku ka pasur problemin, e kemi detyrë dhe këtë po bëjmë me këtë ligj. Me këtë ligj jemi kthyer që të mbikëqyrim dhe të kontrollojmë më mirë një veprimtari bazuar në disa ligje në ekonominë private, ekonominë e tregut që kemi dhe po e kufizojmë në disa sektorë. Pas disa vitesh mund të na dalin edhe probleme të tjera dhe mund të kufizojmë sërish, por nuk mund ta kthejmë mbrapa.

Mendoj se vendosja e kësaj pike është në sensin e duhur, sepse tani e pash edhe një herë ligjin ekzistues që po ndryshojmë.

Arben Ahmetaj – Faleminderit!

Zonja Gjylameti, ju lutem!

Blerina Gjylameti – Jam në të njëjtën linjë me kolegun Anastas Angjeli dhe do t'ju kërkoja, zoti kryetar, që ta rikthejmë diskutimin në atë çfarë jemi duke bërë ekzaktësisht. Ky ligj është votuar në parim dhe duhet ta votojmë nën për nën. Nga fokusi që ka ndryshimi i ligjit për të përmirësuar monitorimin, mirëmenaxhimin e kontratave koncesionare dhe kufizimin atje ku, sipas rekomandimeve të institucioneve ndërkombëtare financiare dhe kërkesave tona të brendshme për

të përmirësuar performancën e kontratave apo kufizuar, kemi pasur probleme, gjatë kësaj seance duhet të merremi nën për nën dhe të mos e rikthejmë edhe një herë të gjithë diskutimin në parim.

Besoj se për të gjitha shqetësimet që kemi sot këtu, të të gjithë kolegëve, do të kemi seanca të tjera me përfaqësues nga ministritë përkatëse ku të arrijmë të sqarojmë të gjitha pikëpyetjet ose të propozojmë ndryshime të tjera ligjore. Është në të drejtën tonë si deputetë që, nëse kemi propozime, t'i konkretizojmë edhe në nisma ligjore.

Faleminderit!

Arben Ahmetaj – Faleminderit!

Kalojmë te propozimi i zotit Ismet.

Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Nuk miratohet.

Jeni dakord për nenin, sipas variantit të sjellë nga qeveria? Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 9.

Komisioni i Veprimtarive Prodhuese ka sjellë një sugjerim.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ky është komenti ynë për teknikën ligjore.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Po, e qartë.

Komisioni i Veprimtarive Prodhuese ka rekomanduar që në nenin 9 të shtohen dy pika, si më poshtë vijon:

Pika 2 të riformulohet: “Studimi i fizibilitetit përmban në mënyrë të veçantë përmbledhjen operacionale dhe përshkrimin e përgjithshëm të projektit, vlerësimin e risqeve të drejtpërdrejta financiare në ndikimin e buxhetit të qeverisë qendrore dhe vendore, vlerën e parashikuar dhe kohëzgjatjen e propozuar të kontratës, analiza teknike, financiare, ekonomike dhe ligjore, studimet mjedisore dhe implikimet në natyrë, anekset shoqëruese, shtesat e kërkuara, konkluzionet dhe rekomandimet, përcaktimin e llojit dhe objekti i koncesionit të partneritetit publik privat”.

Pika 5, propozimi tjetër, shfuqizohet.

Ka komente?

Zoti Angjeli, ju lutem!

Anastas Angjeli – Kam përshtypjen se kalojmë nga ligji në Rregullore. Neni 17 në fund, ka përcaktuar ...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Alma, të mbarojmë me këtë?

Në fund të ligjit, në nenin 17 thuhet: “Këshilli i Ministrave brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji nxjerr aktet nënligjore të përcaktuara në nenet 3, 5”. Do të shtojmë edhe nenin 6, sepse thamë që do të dalë një vendim i Këshillit të Ministrave. Këshilli i Ministrave dhe Ministria e Financave t’i nxjerrë të gjitha këto, sepse nuk bëjmë ligj, por bëjmë Rregullore.

Arben Ahmetaj - Unë do t'ju sugjeroja të vazhdojmë në të njëjtën vazhdë, që ta lëmë nenin 19 të ligjit vetëm me ndryshimet që kanë ardhur nga qeveria, sepse janë të detajuara të dyja.

Anastas Angjeli – I vendosim në fund të nenit 17.

Arben Ahmetaj – Janë tashmë të vendosura në ligjin aktual, nuk kemi nevojë të bëjmë bashkimin.

Unë do t'i sugjeroja komisionit të mos e marrë parasysh rekomandimin e Komisionit të Veprimtarive Prodhuese dhe të vazhdojmë me ndryshimet e teknikës ligjore.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Po.

Të kalojmë me variantin e qeverisë me ndryshimet e teknikës ligjore.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Po, Landi.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Anastas Angjeli – Po, nuk ka ndryshim.

Arben Ahmetaj – Ligji aktual i ka të mirëpërcaktuara dhe ...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Jo.

Komisioni nuk ka sjellë zgjerim, por i ka përsëritur të bashkuara. Ne nuk duam t'i bashkojmë, sipas sugjerimit tim. Të jenë të detajuara, sepse janë dy pjesë të ndryshme të procedurës, dhe të ecim me variantin e qeverisë, me ndryshimet e teknikës ligjore të propozuar.

(Diskutime pa mikrofon.)

Senida Mesi – Komenti im për nenin 9 shkon drejt asaj që ju dhe unë, zoti kryetar, në qeveri kemi punuar edhe me pjesën e deregulimit. Këtu kërkohet që para shpalljes së procedurës dhe dhënies me koncesion, autoritetet kontraktuese dërgojnë studimin e fizibilitetit dhe çdo ndryshim të mëtejshëm në Ministrinë përgjegjëse për Financat. Tashmë autoriteti kontraktues e ka dërguar studimin e fizibilitetit tek agjencia përkatëse që trajton koncesionet. Në kuadër të deregulimit, pse duhet të dërgojnë të njëjtin dokumentacion në disa institucione shtetërore, ndërkohë që institucioni shtetëror, që do të merret me trajtimin e koncesioneve, është pikërisht agjencia? Nëse Ministria e Financave dhe e Ekonomisë do të marrë informacion, të komunikojnë me institucionin tjetër. Të mos e bëjmë sërish biznesin.

Në këtë ligj duhet të shikojmë edhe në këndvështrimin e biznesit, çfarë po lehtësojmë dhe sa transparentë do të jemi ne me ndryshimet ligjore, që edhe biznesi të jetë shumë më i qartë me procedurat, çfarë pritet dhe çfarë nuk pritet nga ana e tij dhe të mos i ngarkojë me dorëzim dokumentacioni në disa institucione.

Arben Ahmetaj – Në respekt, zonja Mesi, të punës shumë laboroze të lavdërueshme që keni bërë me deregulimin, këtu ka lidhje me ruajtjen e stabilitetit fiskal.

Pse e them këtë? Do t’ju jap një shembull konkret, por pa e dominuar. Deri dje, kontratat që kishin edhe efekte financiare, vinin në Ministrinë e Financave në fillim dhe kur mbaronte negociimi i kontratës nuk vinin sërish. Çfarë po themi këtu? Nuk ka të bëjë me atë që biznesi po shkon tek administrata, por është administrata me administratën. Shiko çfarë po thotë: “Për qëllime të zbatimit të pikës 6 të këtij neni, autoriteti kontraktues duhet të dorëzojë studimin e fizibilitetit të objektit dhe draftkontratën pranë Ministrisë përgjegjëse për Financat”. Çfarë kemi bërë këtu? Në hapin e fundit, draftkontrata shkon sërish te Ministria e Financave, që duhet të shkojë, dhe si autoriteti përgjegjës për ruajtjen e stabilitetit financiar dhe fiskal, në rastin konkret, fiskal, ta shikojë draftkontratën përfundimtare dhe t’i japë miratimin brenda kuadrit të vetë. Pra, nuk kemi shtesë një procedurë midis biznesit dhe ministrisë, por autoriteti kontraktor shkon te Ministria e Financave për të dorëzuar draftkontratën para se të kalojë në kontratë. Në këndvështrimin tim, kjo është e domosdoshme dhe nuk ka të bëjë me deregulimin.

Unë mendoj, dhe kjo është një nga pikat më kryesore në procedurën e detajuar që kemi shtuar në ligj, se është shumë e rëndësishme që Ministria e Financave të kryejë misionin sot e mot më mirë nga se sa e ka kryer në të kaluarën dhe ta pajisë me instrumente dhe procedura ligjore.

Unë sugjeroj të ecim me variantin e qeverisë.

Ka komente?

E hedhim në votim.

Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kalojmë te neni 10.

Ka komente, përveç titullit?

Ju keni harruar, bashkë me mua, t’i vendosim titullin nenit 25 dhe për këtë arsye komisioni do të na ...

(Nuk dëgjohet.)

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Jo, juve nuk jua heq dot.

Atëherë, i vendoset titulli nenit dhe me ndryshimin që iu referuan e votojmë.

Kush është pro me ndryshimin që referuam? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 11.

(Nuk dëgjohet.)

Për sa i përket nenit 11, që bën ndryshimet e nenit 26, Komisioni i Veprimtarive Prodhuese i është referuar pikës 4.

Pra, te neni 11 shtohet pika 1\1: Pika 4 shfuqizohet.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

“Afati i vendosur në pikën 3 të këtij neni nuk mund të zgjatet në rastet e arsyetuara siç përcaktohet në dokumentet e tenderit”.

Ka ndonjë koment nga administrata për këtë?

Zonja zëvendësministre, keni ndonjë koment për këtë propozim?

Albana Shkurta – Jemi dakord me propozimin.

Arben Ahmetaj – Rekomandohet përfshirja e komentit të Komisionit të Veprimtarive Prodhuese. Hedhim në votim nenin 11 me këtë ndryshim, në rrjedhje të rekomandimit të Komisionit të Veprimtarive Prodhuese.

Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 12.

Ka ndonjë koment?

Po, Ismet.

Ismet Beqiraj - Kam një pyetje për nenin 12, ku thuhet: “sigurimi i kontratës do të jetë deri në 5%”. Pse deri në 5%? Nëse lihet evazive, kush e kushtëzon nivelin e kontratës që do të lidhet? Do të jetë 1, 2, 3, 4 apo 5.

Arben Ahmetaj – Ju lutem, përgjigjuni pyetjes.

Albana Shkurta – Në secilin nga dokumentet e tenderit përcaktohet rast pas rasti sa do të jetë kjo vlerë. Në kuptimin e këtij ligji, 5%-i është vendosur si limit i sipërm, kurse në çdo procedurë përcaktohet rast pas rasti sa duhet të jetë në varësi të kontratave.

Ismet Beqiraj – Qofsha i gabuar, por në praktikat e sigurimit të kontratave, qoftë për tenderët, qoftë për koncesionet, ka qenë një vlerë fikse 10%. Nesër ose pasnesër, duke siguruar

kontratën, shteti e detyron t'i marrë vlerën, sepse kështu lihet evazive. Propozimi im është që të bëhet 5% e vlerës së kontratës dhe jo deri në 5%.

Arben Ahmetaj – Për t'iu referuar, ligji aktual e lë të hapur pa tavan dhe pa dyshe. Neni 28 i ligjit aktual thotë: “Para nënshkrimit ose hyrjes në fuqi të kontratës, autoriteti kontraktues merr nga ofertuesi më i suksesshëm garancitë e kërkuara për realizimin e kontratës dhe instrumentet e sigurisë si kompensim për dëmin që mund të shkaktohet si pasojë e dështimit të koncesionarëve, partneritetit publik-privat, për të përmbushur detyrimet e parashikuara në kontratë: premtimi për pagesë, garanci bankare, garanci të korporatës, pasi këto janë të përcaktuara edhe në dokumentet e tenderit, ose vendimin për zgjedhjen e ofertës më të suksesshme”.

Pra, nuk ka pasur referim specifik. 10% është për prokurime publike, kurse këtu jemi në një situatë tjetër.

Kështu që, unë sugjeroj që të ecim me variantin e paraqitur nga qeveria, e cila ka vendosur një nivel deri në 5% dhe t'ia lëmë administratës që në dokumentet e tenderit, në bazë të riskut që mund të paraqesë kontrata për shërbimin apo për mallrat, t'i referohet garancisë.

Ka ndonjë mendim tjetër?

Faleminderit!

Hedhim në votim nenin 12, sipas variantit të qeverisë.

Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 13.

Ka ndonjë koment apo pyetje?

Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 14.

Ka ndonjë pyetje?

Po, Ismet.

Ismet Beqiraj – Si për nenin 14 ashtu edhe për nenin 15 kam vetëm këtë pyetje?

Te pika 7 bëhet një ndryshim: “çdo ndryshim i kontratës së koncesionit me mbështetje financiare, që merr përsipër risqe fiskale vetëm pas marrjes së miratimit nga ministria përgjegjëse për financat, e cila vlerëson në përputhje me kriteret e përcaktuara, dërgohet për miratim në Këshillin e Ministrave nga autoritetet kontraktuese”. Për këtë pikë, por edhe për pikën 5 të nenit 15 është i njëjti problem. Këtu merret risku fiskal dhe kjo buxhetohet. Përveç miratimit

nga Këshilli i Ministrave, meqenëse ndërhyr në buxhet dhe rialokohen fonde, është e nevojshme që të ratifikohet edhe në Kuvendin e Shqipërisë?

Arben Ahmetaj – Është shumë e qartë që nuk është e nevojshme përderisa nuk ka ardhur kontrata bazike. Pra, nuk është e nevojshme të vijë në Kuvend, sepse Kuvendi është jashtë procedurës. Vetëm për kontrata specifike, kur autoriteti kontraktor ose koncesionari mund të kërkojë, mund të vijë në Kuvend. Nuk mund të vijë në Kuvend, sepse vjen ligji i buxhetit.

Hedhim në votim nenin 14, sipas variantit të qeverisë.

Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 15.

Ka ndonjë pyetje apo koment?

Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 16.

Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 17. Dispozitat e fundit.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Anastas Angjeli – Te pika 3, Këshilli i Ministrave nxjerr aktet nënligjore për nenet 3, 5

...

Arben Ahmetaj – E shtuam.

Anastas Angjeli – Dakord, por ta themi edhe këtu, sepse duhet.

Arben Ahmetaj – E shtuam dje te neni, por duhet ta shtojmë edhe këtu, thoni ju?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Te neni 6?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Dakord.

Ne e parashikuam për këshilltarët e jashtëm, që ju thatë se ekzistojnë.

Me të gjitha ndryshimet që kemi sugjeruar për rregullimin e teknikës legjislative.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, po.

Me këtë ndryshim që iu referuam në pikën 3, për sa i përket asaj që duhet të nxjerrë Këshilli i Ministrave, do të shtohet edhe neni që iu referuam për sa i përket funksionimit të komitetit të përzgjedhjes.

Neni 18. Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kemi një reformulim për nenin 18: Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare, me përjashtim të nenit 2, nenit 7 pika 1 dhe nenit 9 të këtij ligji, të cilët hyjnë në fuqi në datën 1 korrik të vitit 2019.

Zonja zëvendësministre, keni ndonjë koment për këtë?

E votojmë nenin 18 me ndryshimin e bërë.

Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

E votojmë ligjin në tërësi.

Kush është dakord me ndryshimet e sjella nga qeveria dhe të votuara nën për nen në komision për projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.125/2013, “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, të ndryshuar””? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Faleminderit!

MBYLLET MBLEDHJA

Sekretar
Anastas Angjeli

Përgjegjësja e Sektorit të Redaktorëve
Euzheni Pengili

Sekretar i komisionit
Elvi Prifti

